



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Raport për rezultatet e konsultimit publik

1. Titulli i draft aktit

Projektvendimi “Për miratimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Projektvendimi “Për miratimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte”, bazuar në autorizimin ligjor sipas nenit 34, pika 10, të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i është nënshtruar procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP), nga data 25.05.2026 deri më 22.06.2026 .

3. Metoda e konsultimit

Në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, projektvendimi është publikuar në portalin zyrtar RENJKP, duke i dhënë mundësi palëve të interesuara të paraqesin komente dhe sugjerime.

4. Palët e interesit të përfshira

Eksperte mjedisi.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Projektvendimi i rishikuar bazuar në autorizimin ligjor sipas nenit 34, të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ka patur 161 shikime dhe 1 (një) koment nga faqja e RENJKP.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Projektvendimi “ Për miratimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për	Në projektvendim dhe relacionin shpjegues nuk jepet informacion se cilën Direktivë apo	Z.Polikron Horeshka .	I refuzuar	Komenti nuk u mor në konsideratë,duke argumentuar se projektvendimi nuk ka transpozuar asnjë acquis

<p>venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte</p>	<p>Rregullore ka traspozuar ky dokument si dhe % e përputhshmërisë, pjesë e kërkesave të integritit të BE dhe Kapitullit 27. Kërkohe të vihet në dispozicion Direktivën e përputhshmërisë të hartuar sipas neneve.</p>			<p>të BE, por është një akti ligjor që rrjedh nga neni 34 I Ligjit 75/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Për këtë arsye nuk mund t’ju vendosim në dispozicion as % e përputhshmërisë dhe as aktin e transpozimit.</p>
	<p>Referuar ndalimet e distancave të Nenit 4, Kreut II ‘Kërkesat teknike për ndërtimit dhe operimit’ ku: - në distancë 300 metra nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burim tjetër ujor; - në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor; - në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur, kërkohe të jepet një sqarim i detajuar teknik se kujt baze ligjore jeni bazuar për vendosjen e këtyre kritereve të distancës si dhe sa është në përputhje me detyrimet e ligjit Nr. 29/2024 ‘Për burimet ujore’ dhe aktet ligjore në fuqi.</p>	<p>Z.Polikron Horeshka .</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Kriteret për përcaktimin e vendndodhjes së venddepozitimeve të përkohshme janë bazuar në parimet e kuadrit europian për menaxhimin e mbetjeve, në veçanti në kërkesat e Direktivës 1999/31/KE “Për landfill-et e mbetjeve”, të ndryshuar, si dhe në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e burimeve ujore dhe zonave të mbrojtura, përfshirë ligjin nr. 29/2024 “Për burimet ujore” dhe ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar. Këto akte përcaktojnë detyrimin për të shmangur vendosjen e aktiviteteve me potencial ndotës në afërsi të burimeve ujore dhe zonave të ndjeshme mjedisore, në mënyrë që të garantohet mbrojtja e tyre, pa përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë distanca fikse, por duke kërkuar marrjen e masave parandaluese dhe aplikimin e</p>

			<p>zgjdhjeve të sigurta nga pikëpamja mjedisore. Në këtë kuadër, distancat e përcaktuara në projektvendim nuk përbëjnë riprodhim të drejtpërdrejtë të një dispozite të vetme ligjore, por përfaqësojnë masa parandaluese teknike (buffer zones), të vendosura mbi bazë të praktikave të njohura të projektimit dhe menaxhimit mjedisor, me qëllim minimizimin e rrezikut të ndotjes. Nga pikëpamja teknike, këto distanca synojnë:</p> <ul style="list-style-type: none">- mbrojtjen e ujërave nëntokësore, përmes krijimit të një zone amortizuese që lejon filtrimin natyror të mundshëm të ujërave të infiltrimit dhe reduktimin e rrezikut të ndotjes së akuiferëve (distanca prej 300 m nga pusët dhe burimet ujore);- shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë me ujërat sipërfaqësore dhe reduktimin e rrezikut nga rrjedhjet sipërfaqësore dhe përmytjet (distanca prej 100 m nga lumenjtë, përrenjtë dhe trupat e tjerë ujorë);- krijimin e një zone tampon për mbrojtjen e biodiversitetit dhe integritetit ekologjik të zonave të mbrojtura nga ndikimet indirekte të
--	--	--	---

				<p>aktivitetit (distanca prej 300 m);</p> <p>- garantimin e stabilitetit gjeoteknik të terrenit dhe reduktimin e rreziqeve që lidhen me erozionin dhe përmytjet.</p> <p>Këto masa janë në përputhje me qasjen e përcaktuar në Direktivën 1999/31/KE, e cila, ndërsa nuk përcakton distanca fikse, kërkon që vendndodhja e impianteve të menaxhimit të mbetjeve të zgjidhet në mënyrë që të mos paraqesë rrezik për mjedisin, në veçanti për ujërat dhe zonat e ndjeshme.</p>
	<p>Në projektakt nuk jepen detaje teknike se çfarë kriteresh kërkohen për ndërtimin e venddepozitimit të përkohshëm lidhur me: - Për klasifikimin e llojeve të tokave që do të përzgjidhet landfilli? - Llojet e shresave të membramave të ndërtimit të landfillit? - Distancat e shtretëzimit? - Llojet e tubacionit të përthithjes së biogazit? - Llojet e impianteve të trajtimit të llumrave të gjeneruara nga landfilli? - Studimet gjeologjike, hidrologjike? - rrezikun e</p>	<p>Z.Polikron Horeshka .</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Sugjerimet e paraqitura lidhen me detaje të thelluara teknike të projektimit dhe ndërtimit të venddepozitimeve, të cilat tejkalojnë natyrën dhe qëllimin rregullator të projektvendimit. Projektvendimi përcakton kuadrin bazë të kërkesave teknike, mjedisore dhe administrative për venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte, ndërsa aspektet specifike teknike, si klasifikimi i tokës, shtresat e izolimit, parametrat gjeoteknikë, vlerësimi i rreziqeve natyrore apo zgjidhjet inxhinierike, trajtohen në fazën e hartimit të projekteve teknike dhe</p>

	<p>përmytjes, fundosjes, shkarjes së dherave? - kontrollohen ujërat që futen në trupin e lëndfillit nga precipitimet/reshjet? - Shtresë izoluese? - Kodin e mbetjeve sipas katalogut që përfshihet dhe zbatohet ky vendim? - Vlerat kufi të lëngëzimit dhe bazën ligjore që do të ndiqet ky vendim? - Materialet e ndërtimit, që përmbajnë asbest dhe lloje të tjera mbetjesh asbesti a do të lejohen të depozitohen si mbetje inerte?</p>			<p>dokumentacionit përkatës për leje, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, një pjesë e çështjeve të ngritura në koment, si sistemet e përthithjes së biogazit apo impiantet e trajtimit të llumrave, nuk janë të aplikueshme për venddepozitimet e mbetjeve inerte, për shkak të natyrës së tyre, e cila nuk përfshin procese biologjike të dekompozimit. Për sa i përket pranimit të mbetjeve, projektvendimi përcakton kërkesat për klasifikimin dhe ndalimin e mbetjeve të papranueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë edhe ndalimin e mbetjeve të rrezikshme.</p>
	<p>Në projektvendim nuk jepen informacion apo e përcaktuar lidhur me kostot dhe tarifat që duhet te paguajnë operatorët në llogari të buxhetit të shtetit dhe kostot për ton që do të paguhen në llogari të operatorit. Kërkohet të pasqyrohet edhe baza ligjore për efektet financiare për zbatimin e këtij akti.</p>	<p>Z.Polikron Horeshka .</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Projektvendimi është plotësuar me përcaktime të natyrës parimore lidhur me mekanizmat e financimit të operimit të venddepozitimeve të përkohshme. Projektvendimi nuk synon të përcaktojë nivele konkrete tarifash apo kosto për njësi (p.sh. kosto për ton), pasi këto elemente nuk përbëjnë objekt të një akti rregullator të këtij niveli dhe varen nga faktorë teknikë, ekonomikë dhe</p>

				<p>kontraktualë që përcaktohen në fazën e operimit.</p> <p>Gjithashtu në projektvendim është reflektuar parimi “ndotësi paguan”, si dhe janë parashikuar mekanizmat financiarë të lejuar nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, duke qartësuar se kostot e operimit dhe menaxhimit përballohen nga operatori dhe subjektet përkatëse, pa krijuar detyrime të drejtpërdrejta për buxhetin e shtetit.</p> <p>Sa i përket bazës ligjore, projektvendimi mbështetet në ligjin nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili përcakton parimet e financimit në këtë fushë, përfshirë parimin “ndotësi paguan” dhe përgjegjësinë e subjekteve për mbulimin e kostove të menaxhimit të mbetjeve.</p>
	<p>Në dokument nuk përcaktohet vlera dhe garancia financiare që duhet të paguajë në llogari të buxhetit të shtetit operatori i venddepozitimit të përkohshëm.</p> <p>Kërkohet një interpretim teknik dhe ligjor për garancinë dhe vlerën financiare që do ndiqet në këtë vendim.</p>	<p>Z.Polikron Horeshka .</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Projektvendimi parashikon detyrimin për sigurimin e një garancie financiare nga operatori për mbulimin e kostove të mbylljes dhe rehabilitimit të venddepozitimeve të përkohshme.</p> <p>Konkretisht, në nenin 13 të projektvendimit është parashikuar që operatori të sigurojë paraprakisht fondet përkatëse përmes</p>

				<p>një garancie financiare, përfshirë garanci bankare ose policë sigurimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Projektvendimi nuk përcakton një vlerë fikse apo formulë të detajuar për llogaritjen e kësaj garancie, pasi ajo varet nga parametrat specifikë të çdo venddepozitimi, si madhësia, kapaciteti, karakteristikat teknike dhe kostot e rehabilitimit, të cilat përcaktohen në fazën e projektimit dhe miratimit.</p> <p>Sa i përket bazës ligjore, ky parashikim mbështetet në ligjin nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili parashikon përgjegjësinë e operatorit për mbulimin e kostove të menaxhimit dhe rehabilitimit, si dhe në parimin “ndotësi paguan”.</p>
	<p>Në nenet e këtij projektvendimi nuk paraqitet veprimet lidhur me abandonimet që mund të bëjnë operatotët për mos përmbushjen e kritereve si dhe çfarë do të bëhet me venddepozitimet inerte të cilët janë krijuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Kërkohet një interpretim teknik dhe</p>	<p>Z.Polikron Horeshka .</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Projektvendimi parashikon mekanizma të qartë për trajtimin e mosrespektimit të kushteve të operimit dhe për mbylljen dhe rehabilitimin e venddepozitimeve.</p> <p>Sa i përket rasteve të mosplotësimit të kritereve nga operatori, projektvendimi përcakton detyrimet e këtij të fundit për përmbushjen e kërkesave teknike dhe</p>

	juridik për trajtimin e kësaj pike.			<p>mjedisore, si dhe parashikon ndërprerjen e aktivitetit dhe fillimin e procedurave të mbylljes dhe rehabilitimit në rast të shkeljeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mekanizmat e kontrollit dhe inspektimit.</p> <p>Gjithashtu, janë parashikuar instrumente për garantimin e përmbushjes së këtyre detyrimeve, përfshirë sigurimin e një garancie financiare për mbulimin e kostove të mbylljes dhe rehabilitimit, në zbatim të parimit “ndotësi paguan”.</p> <p>Sa i përket venddepozitimeve të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në rast identifikimi të tyre në praktikë, ato do t’i nënshtrohen kërkesave të këtij vendimi dhe proceseve të verifikimit dhe përputhshmërisë me standardet e përcaktuara.</p>
	Në pikën 3 të nenit 15 të këtij projektvendimi ka përcaktuar institucionet që ngarkohen për zbatim si: Ministria përgjegjëse për mjedisin, Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), operatorët dhe strukturat përgjegjëse	Z.Polikron Horeshka .	I refuzuar	<p>Projektvendimi përcakton institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e tij në funksion të roleve të tyre të drejtpërdrejta në procedurat e miratimit dhe kontrollit të venddepozitimeve të përkohshme.</p> <p>Sa i përket Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve</p>

	<p>inspektuese. Kërkohej një interpretim teknik dhe ligjor pse nuk janë përfshirë për zbatim Agjencia Kombëtare e Mjedisi, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, IKMT, Policia e Shtetit dhe Njësitë e Pushtetit vendor për zbatimin e këtij akti.</p>			<p>(AKEM sh.a.), ajo është trajtuar në projektvendim në cilësinë e operatorit, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 57/2025, duke ushtruar funksionet e administrimit dhe operimit të venddepozitimeve të përkohshme, dhe jo si institucion i veçantë në kuadër të dispozitës së zbatimit. Ndërkohë, institucionet e tjera të përmendura në koment, si Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Policia e Shtetit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, ushtrojnë funksionet e tyre në bazë të legjislacionit sektorial dhe horizontal në fuqi, që rregullon kontrollin, monitorimin, inspektimin dhe rendin publik. Përfshirja e tyre e drejtpërdrejtë në dispozitën e ngarkimit për zbatim nuk është konsideruar e nevojshme, pasi kjo do të sillte mbivendosje të kompetencave dhe do të dilte përtej objektit rregullator të këtij akti.</p>
--	--	--	--	--